REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 26.11.2025 Prot.46 (dyzetëegjashtë)

Protokoll nr. 46

I mbajtur sot më datë 26.11.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.11.2025.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2025";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.P.B banues në fshatin Sojan NJ.A Pirg, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
6.P-V "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit, për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë";
7.P-V "Për mbylljen e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetës Maliq dhe kalimin pranë stukturës së Bashkisë Maliq";
8. "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Maliq nr.75 datë 30.06.2025, *"Për ngritjen e bordit artistik të Bashkisë Maliq";*
9. "Për miratimin e dokumentit të Politikave, Planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Maliq për periudhën janar-dhjetor 2026";
10.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari;Aramando Dautllari; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Kristina Malelli; Enida Avdolli; Klea Baçi; Plator Çollaku; Floreta Zaçe; Pranvera Begolli; Selami Muço; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Andonaq Risto; Almir Elezi; 18 (tetëmbëdhjetë) këshilltarë

Mungesa: Marinathi Avrami; Danjela Ibrahim; Neresida Shindo; Gentiana Drabo; Xhuana Hoxhallari; Eriseld Jonusllari; Fevri Sherifi; Rovena Terolli; Ilia Xhuti; Marjeta Xhelollari; Yllson Ibrahimllari; Albina Xhejo; Dalina Krekas; 13 (trembëdhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta; Përgjegjësi i Zyrës të Strehimit:z.Ledion Mullalli.

Ornildi Demollari:Të fillojmë atëherë mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, i nderuar kryetari i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës. Fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliqit, sikurse jeni njoftuar disa ditë më parë. Fillimisht, verifikojmë korumin. Korumi realizohet. Janë gjashtëmbëdhjetë këshilltarë në sallë dhe mund të vijojmë me rendin e ditës.

Petrit Kupe: Me leje, jam një mendim i paraprakisht përpara se të miratohet deri në ditë. Kryetari është këtu. Duam një tablo të më të qartë dhe jo vetëm për ne, por edhe për gjithë opinionin që na ndjek. Mbi situatën e krijuar nga reshjet e fundit, besoj se kryetar është e nevojshme kjo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Të flisja diçka për situatën e përmbytjeve dhe pastaj mbledhjen e këshillit ta vazhdojë dikush nga punonjësit tim dhe unë të vazhdoj në terren.

Ornildi Demollari: Mos duhesh për materiale të tjera?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Për të tjerët, dakord, diçka vetëm për atë pike, për Agjencinë. Në qoftë se e kaloni atë të parën, në qoftë se keni ndonjë pyetje, pasi gjithë të tjerat janë problematikat që s'kanë të bëjnë me pjesë financiare. Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, situata e ditëve të fundit ka qenë një situatë emergjente. Data njëzet i njëmbëdhjetë i dy mijë e njëzet e pesë ka arritur kulmin. Nga ajo çfarë dua të them, është një situatë ku rreshjet kanë arritur maksimumin e tyre. Nuk e di në s'kam një informacion të saktë, por nuk kemi parë një sasi rreshjesh të tilla. Mund t'u shpjegojë. Është zyrtarisht që në tre ditë apo tre ditë e gjysmë kanë rreth treqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katër milimetra shi, aq sa rajoni i Korçës e ka për tre në gjashtë muaj. Domethënë tre ditë me gjashtë muaj, një prurje shumë e madhe, e cila në një farë mënyre ka mbushur tej masës dy lumenjtë, që ka qënë Dunaveci edhe e lumit Devoll. Unë personalisht nuk hyj në njerëzit që s'marr përgjegjësi dhe nuk marr apo nuk kritikoj institucionet apo strukturat tona. Dhe patjetër që situata është komplekse. Është komplekse edhe për pavarësisht prurjeve shumë të mëdha që kanë rënë. Argjinatura e lumit Devoll, veçanërisht ajo e lumit Devoll, ka patur problematika, në mbjellje të argjinaturave, në disa hapje rrugësh të veçanta, të cilat në një moment të caktuar dhe japin ngarkesë, por prurjet e mëdha në zonën që është bërë çarja e lumit Devoll, është një zonë ranore me rërë, e cila është shumë e vështirë për ta mbajtur, por kjo në një farë mënyre nuk është justifikim. Ajo kërkon minimalisht projekte shumë të mëdha nga qeveria qëndrore, që kanë të bëjnë me mbathjen jo me rërë, apo me dhe, apo me çakëll. Por me gurë, me rrjetë gabionë, me projekte të thella, të cilat, edhe pse këto situata ndoshta vijnë një herë njëqind vjet. Pavarësisht, ne duhet të pregatitemi edhe për periudha të tilla.

Çarja që ka ndodhur në lumin e Dunavecit ishte më e lehtë, edhe pse aty ka qenë prurja më e madhe për efekt të rreshjeve në momentin e parë. Por uji, siç hynte, dilte, siç hynte, dilte prapë në lumin Devoll. Dhe përmbytja ishte më e lehtë dhe ato pothuajse janë drejtë tharjes në këtë moment që flasim, edhe pse rreshjet vazhdojnë të bien. Për të informuar Këshillin e Bashkisë, dua të shpjegoj që situata ka qenë e përgjithshme në të gjithë territorin e bashkisë. Në njësinë administrative Gorë dhe Moglicë kemi patur katër ura të dëmtuara, urën e Desmirës, Osojës, Dusharit dhe Gjinikasit. Rrugë të dëmtuara, rruga Mesmal- Velçan, Strelc-Lozhan, Fshat Desmir, Moçan, Fshati Dolan. Kemi bërë pothuajse riparimin në rikuperimin e të gjithë rrugëve rurale të zonës së Gorës, me përjashtim të Mesmalit, ku so kemi çuar një eskavator për të bërë riparimin, pasi me fadrom nuk arritëm ta realizonim para dy ditësh. Pasi dëmtimi nga lumi i Mesmalit ka qenë aq i madh sa fadroma nuk bënte asnjë punë. Dhe e patëm të vështirë për të çuar eskavator në dy ditët e para, pasi është punuar në lumin Devoll me rreth njëzet e pesë mjete, mund të them që është bërë një punë shumë shumë e madhe, por ende s'kemi vajtur tek çarja, të themi. Kemi bërë një transport me rreth tetëdhjetë rrugë çakëll nga Guroja te Zvezdës në drejtim të çarjes së lumit Devoll. Me mbështetje të forcave të ushtrisë, me mbështetje të kompanive private, të cilat dua t'i falenderoj patjetër, dhe me mjetet e bashkisë dhe bordit të kullimit. Dua të saktësoj në emër të Këshillit të Bashkisë, por edhe të qytetarëve që janë lumenjtë apo kolektorët kryesorë të fushës Maliqit, nuk menaxhohen nga bashkia. Jo për ta hequr si përgjegjësi, e thashë që në fillim, por lumenjtë, kolektorët kryesorë, siç janë C9, C0, të gjithë ai, Bregasit apo të gjithë. të menaxhohen nga Drejtoria Rajonale e Kullimit, Korçë, Berat, Elbasan, të cilat në një farë mënyre, kurse ne kemi kanale të dyta, të treta e me radhë. Megjithatë, pavarësisht kësaj, rekordimi midis të gjithë strukturave tona duhet të jetë sa më i mirë, që edhe në situata të till, ne duhet të kemi përballim situate apo dëme sa më të vogla. Në nga rreshjet e mëdha kemi patur dëmtime të rrugës në fshatin Dolan, mes mal në Senisht, kemi patur një rrëshqitje dheri shumë të madh për efekt të depo-s. Kemi bërë një ndërhyrje të shpejtë duke e shkëputur ujin nga depot e nga depo e Senishtit dhe kemi bërë një lidhje direkte, pasi rrezikoheshin disa shpi nga rrëshqitja e dherit dhe nga uji në këtë fshat. Dhe sot që po flasim, po punohet për kanalizimin e një linje që ujërat e tepërta të larta të dalin jashtë fshatit, që të shpëtojmë shpirt në këtë fshat. Në njësinë administrative të Pirgut kemi patur rrugë rrëshqitje në fshatin Kakaç. E cila, edhe pse është hapur rruga, nuk është zgjidhur përfundimisht. Ka rrëshqitur komplet shpati i malit. Kemi patur prezencë uji në tridhjetë e tetë objekte, kemi patur dëmtime në dymbëdhjetë hangarë, nëntë magazina të dëmtuara në fshatin Gurisht. Ka pasur dëmtime në murin mbajtës dhe kanalin e fshatit Leminot në njësinë administrative Vreshtas, janë pesëmbëdhjetë familje janë prekur nga prezenca e ujit. Katër stalla dhe katër magazina janë dëmtuar. Pesë banesa të rrezikuar nga shkarja e gurëve dhe pjesa shkëmbore e malit të thatë në Podgorie. Në Njësinë e Administrative të Pojanit kemi dhjetë objekte banimi me prezencë uji, pesë hangarë dhe dy stalla të dëmtuara për shkak të përmbytjeve, bashkë me bazën ushqimore. Në njësinë Administrative Libonik kemi tridhjetë e tre familje të prekura nga prezenca e ujit, pesë hangarë dhe dy stalla. Përfshirë këtu një mijë e katërqind dëngje kashte, treqind e pesëdhjetë kunjtal drithë. Dëmtimi i rrugës që lidh tylben e goçës me fshatin Zboq, Beras, edhe ajo ka dëmtime. Njësia administrative Maliq Qendër në këtë njësi ka identifikuar probleme për katër objekte banimi, një njësi ekonomike. Në totalin e përgjithshëm kemi të dëmtuara njëqind e apo kemi prezencë ujë. Pse të dëmtuar kemi vetëm një

shtëpi në fshatin Zvirinë, e cila është kthyer në të pabanueshme. Edhe ne po negociojmë për ta riparuar sa më pare.Më familja është çuar në një banesë me qira dhe po mundohemi për ta riparuar komplet. Objekte të prekura nga uji janë njëqind e njëzet e tre. Kemi katër ura të dëmtuara, kemi rrugë të dëmtuara. Gjashtë të cilat kanë patur nevojë për ndërhyrje shumë të thellë, bagëti të humbura njëzet e një, shpendë nëntëqind e shtatëdhjetë dhe bazë ushqimore për rreth një mijë e pesëqind krerë bagëti. Kjo është një pasqyrë e përgjithshme ajo çfarë ne kemi bërë në këto ditë, për të cilat kanë qenë të vështira edhe për ne, edhe për punonjësit, po patjetër edhe për ne që drejtojmë. Ne kemi ngritur një grup pune për evidentimin e gjithë situatës, pavarësisht punës së përditshme pa orar për të gjithë, është punuar gjashtëmbëdhjetë orë, jo vetëm nga ne që e kemi detyrë në fund të fundit, por dhe nga kompanitë private, nga forcat e ushtrisë për stabilizimin e situatës. Bazë ushqimore kemi kërkuar nga rezervat e shtetit. Bazë ushqimore për rreth njëqind e pesëdhjetë familje kemi kërkuar bazë ushqimore për gjënë e gjallë dhe për riparimin e pesëdhjetë stallave të prekura nga përmbytja. Veshje për rreth njëqind e pesëdhjetë familje. Kanë filluar të vijë baza ushqimore apo pakot ushqimore për familjet, por kemi patur në këtë pikë edhe ndihmesë dhe kontribut nga organizata të ndryshme, siç janë edhe sot vazhdojmë, por edhe nga organizata lokale, themi për ta lehtësuar situatën. Kemi kërkuar nga rezervat e shtetit bazë ushqimore për blegtorinë, pasi edhe ajo është një ngërç në disa zona të caktuara. Të shpresojmë që të analizojmë shumë shpejt. I jemi drejtuar prefektit të qarkut Korçë për mbështetje. Këto që thashë më lart, edhe rezervave të shtetit, edhe të paralelisht me këtë, kemi ngritur grupin e punës, siç më thashë, i cili ka bërë këtë evidentim paraprak. Por puna do të vazhdojë edhe më tej, për të parë gjithë situatën, si do të ecim më tej. Si jemi në situatën aktuale, kemi përmbyllur riparimin e argjinaturës së lumit, apo është përmbyllur nga drejtoria rajonale e bordit të kullimit. Korçë, riparimi i argjendaturës së lumit të Dunavec. Kemi çakëlluar rreth tre kilometra rrugë nga ura e Sheqerasit në drejtim të çarjes mbi lumin Devoll. Dhe shpresojmë që në varësi të kohës, sot gjë është edhe njëqind pak lagështi, se sot mund ta mbyllnim. Po punohet tranzit nga guroret e Zvezdës në drejtim të urës Sheqerasit. Për të bërë një rezervë materiali për ta kemi në një moment të dytë, kur koha të na lejojë për të për të ecur. Dhe paralelisht me këtë, dy takime që kanë qenë Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Bujqësisë, të cilët kanë ardhur në terren për efekt edhe të situatës, kanë marrë përsipër që viti dy mijë e njëzet e gjashtë. Unë në këtë moment që flasim, edhe po pregatis të gjithë anën shkresore kërkesat buxhetore, të cilat kërkojnë një mbështetje shumë më të madhe në fushën e bujqësisë, në fushën e mbrojtjes civile apo edhe në fusha të tjera që kanë të bëjnë me mjetet e tjera. për efekt të paraprirjes kësaj pune, pasi masat paraprake patjetër lehtësojnë edhe sasinë e mbytjeve në fushë. Unë mendoj që do ta kalojmë këtë situatë. Ka filluar lëvizja e ujit nga fusha në drejtim të kolektorëve dhe të lumit Devoll në një pjesë të konsiderueshme. Pjesa më e vështirë është pjesa torfike në zonën e Sheqerasit, edhe e Vreshtasit, e cila është është edhe në nivel dhe kërkon një kohë më të gjatë për t'u kaluar. Shumë faleminderit.

Almir Elezi: Kryetar, investuat për Hihdrovorin pesëqind milionë. Hidrovori ka tre vjet që dilni nëpër media, edhe akoma nuk është vënë në punë. Nuk jam bërë kanale, të kam thënë disa herë. E kam kualiduar, e bëra, e mbylla, vazhdon situata. Përse kjo gjë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Atëherë, nuk e di ku i gjejnë këto pesëqind milionët, se ndonjëherë i hidhni vetëm shifrat, po po se sa janë s'ka rëndësi. E para, e dyta. Ende nuk ka shkuar uji në hidrohori dhe s'kam ç'heq ujë. Kur të vijë uji në hidrohori, patjetër që ta bëjmë. Dhe të lutem, prit të mbaroj. Dhe do t'i bëjmë dhe një pastrim të fundit kanalit të rezervuarit të Podgories, se nuk mund të mbytim fshatra të tjerë. Edhe pastaj, në qoftë se uji do të vijë tek hidrovatori, i cili është i thatë sot që flasim, atëherë do të çojmë ujë atje ku është.

Almir Elezi: Hidrovori nuk është i thatë. Nizhavecin e ke të mbytur që në shtëpi, edhe poshtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dakord, atëherë.

Almir Elezi:Në qoftë se ti thua hidrofori është i thatë, atëherë hajt të shkojmë, po kështu të mashtrojmë këtu.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kam shkuar dije, unë atje kam qenë vetë. Atëherë të lutem shumë, na lër ta bëjmë punën, siç është për të bërë.

Almir Elezi: Puna për të bërë edhe ujë nuk ka. Atëherë, pse del në media? Ti ke, ke tre vjet që del në media. Një herë del ti, një herë del ai i Pojanit një herë del administratori, ja e bën Hitrovin. Përse një investim që ai sot nuk funksionon? Po s'funksionon, se ti s'i ke parë kanal, ti ke vënë, ke vënë dy tubo majë kodrës. I ke shpën atje dy tubo e dy pompa, po ato s'kanë kanal.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani unë po të shpjegoj. Në momentin e parë, një herë nuk ka ujë në hidrovor dhe ti, kur të duash ti, kur të mbarojmë mbledhja, do të vijmë të dy atje ta shikojmë. Po atëherë, të lutem, të lutem tani, se duhet të jemi të sinqertë me njerëzit. Nuk duhet të gënjejmë kështu, n sot s'ka ujë në hidrovor për ta hequr. Sot që flasim, dije nuk ishte. Sot nuk e di, vetëm po ka rënë natën shumë. Dije nuk ishte, se kam shkuar vetë. E dyta, do t'i bëjmë dhe një pastrim të fundit lumit, kanalit që lidh me rezervuarin dhe patjetër do ta vëmë në punë në qoftë se do jetë e nevojshme edhe ajo është në punë, hidrovori.

Almir Elezi: Unë ka dy vjet që të them, ti thua e kam kualiduar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po faleminderit, kjo është për ju. Patjetër që është e kolauduar..

Almir Elezi: Ku e ke të kolauduar? Ti s'ke bërë kanalin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ore, ka ujë në hidrovor, të lutem?

Almir Elezi: Ore, ka ujë në hidrovor, se të është mbytur Nishaveci i tërë. Edhe ujin e ke deri në Vreshta, si s'ka ujë në hidroborë?

Ornildi Demollari: Almir të lutem me objektiv. Luli po.

Lulëzim Hoxhaj:Së pari, edhe në emrin tim personal të grupit, ndoshta edhe të këshilltarëve të tjerë me fjalë keqardhje dhe mbështetje për të gjithë të dëmtuarit në këtë situatë, vërtetë është një situatë jo e zakonshme, është e jashtëzakonshme. Është e vërtetë ajo që shirat e rëna për një periudhë shumë të shkurtër kanë qenë shumë të mëdha dhe patjetër ato do të reflektonin dhe do të krijoni situata të tilla. Nuk është herë e parë që ndodh kjo. Edhe herët me fjalë kanë ndodhur situata të tilla. Ëh, unë doja nja dy-tre gjëra kështu për të cilësuar për këtë situatë. Personalisht, bashkë edhe me këshilltarët e tjerë të grupit, kemi qenë dhe do të jemi këto kohë në komunitet tek njerëzit, sepse të paktën, të paktën, të paktën, ajo që kemi mundësi të bëhemi me këtë pandehë është të jemi pranë tyre dhe bëj thirrje edhe këshilltarëve të tjerë t'i lëmë ato punë tona të përditshme për këtë periudhë, sepse vërtetë, vërtetë ata e meriton që ne të paktën këtë njerëz. Dhe duke qenë pranë tyre, besoj që mund të evidentojmë edhe ndonjë problem. Unë doja të cilësoja, kryetar, nja dy probleme shumë shkurt të vogla, që ndoshta, ndoshta do të ndihmojn , unë e pashë rrugën e Mesmalit. Edhe ka tre ura mes maleve të rënda, unë nuk e besoj që të ketë dëmtim më të rëndë se sa ajo rrugë. Në këto zona të tjera, nuk ka ashtu dhe shpresoj që mos mos ketë më rëndë. Po të jetë dëmtuar në atë shkallë, edhe ndonjë rrugë tjetër ose ndonjë vend tjetër, besoj që do jetë një katastrofë. Ëh, unë kam dy sugjerime për atë rrugë. Sugjerimi i parë... Po u them kryetar dhe nuk e di a keni qenë dhe vetë atje në këtë në atë vendin atje, por unë po them me një skavator të. Me një makinë dhe me një fadromë atje, hapja e asaj rruge përfundon në muajin korrik. Beson për këtë që po them, po të them këtë, ta them si specialist, nuk e them si këshilltar, po e them si specialist. E para, e dyta. Jam i sigurt që jam dakord me të edhe fatkeqësia natyrore atje ka bërë punën e vet, po e them prapë si specialist dhe këtë vende. Hapja e digës, këtë e them me përgjegjësi, kryetar. Hapja e digës, që është mbi vendin ku është prishur ajo, ka shkaktuar gjithë këtë katastrofë. Dhe me këtë rast, nuk është për të falenderuar në këtë zonën tjetër me fjalë, jam dakord që firmat kanë kontribuar dhe duhen falenderuar, po të paktën, të paktën, të paktën për atë zonë. Ata, jo vetëm që nuk janë për të falenderuar kryetarët, por atyre janë për t'u dhënë urdhër. Edhe t'ju thuhet që nga tre urat dhe deri në fund, ku mbaron, ku mbaron, ku del, ku takohemi me Pogradecin. Atë rrugë mundësisht të asfaltojnë, e kanë detyrim. Sepse përfitojnë, janë përfituesit kryesorë të atij lumi dhe mendoj, mendoj, dhe edhe ligji e parashikon. Unë nuk jam në gjendje tani ta them ligjin saktë, po dhe ligji e parashikon. Nuk do të ishte ndodhur kjo katastrofë në rast se nuk ishte hapur diga. Nuk do ishte ndodhur kjo katastrofë në rast se lumi do ishte, sepse lumi duhet mirëmbajtur. Vërtetë shfrytëzon atë, po të ishte mirëmbajtur, unë atje kam parë shkëmbinj kryetar. Të them, jam çuditur. Dhe po e them, atje duhen përqëndruar mjete, mjete njerëz. Nuk bëhet ajo me një ekskavator, as me dy makina. besomë për këtë po them. Sepse pastaj është tjetër kot, pastaj të themi që janë kaq familje të bllokuara andej,e tjera.

Ornildi Demollari: Luli, faleminderit.

Lulëzim Hoxhaj: Prit, se edhe një dy gjëra të vogla. Kur diskutojmë për parandalimin e këtyre dhe këtë pandehë, ne më mirë është të diskutojmë kur ka diell në kohë behari tani në këtë situatë

nuk kemi sa të diskutojmë. Ne mund të themi vetëm atë të paktën të shpëtojmë nga kjo situatë, edhe të krijojmë situata sa më të mira. Por unë, kryetar, them për të shpëtuar fusha e Maliqit, pavarësisht se nuk është kjo kompetencë e bashkisë, nuk është. Ndoshta, ndoshta as e ka qeveria në dorë këtë, po duhet insistuar shumë. Ka vite, vite, vite. Vite-vite me fjalë që ndodh kjo situatë, kjo nuk zgjidhet me këto kullime të pjesshme, etjera, etjera. Kjo ka vetëm një zgjidhje. Një projekt i ideuar të them shumë vite më parë nga Dhimitër Vogli. Kjo zgjidhet vetëm me hidrovorë të fuqishëm në Ura e Maliqit. Sepse edhe thellimi i lumit Devoll nuk mund të thotë ashtu, sepse vetë e gjen një kuotë dhe nuk mund të ashtu më. Por ka një kuotë dhe pastaj fillon një masë shkëmbore që është e padepërtueshme. Dhe është muhabet i provuar me një fjalë. Prandaj, ndoshta, ndoshta, është një investim, ndoshta pak i kripur, por them që ia vlen. Sepse gjithë kjo fushë, unë them që ajo do jetë shpëtimi i fushës maliqit, sepse kjo do jetë. Sa herë që do të ketë në rreshje, do të jetë kjo situatë, do të do të ashtu. Kam edhe diçka tjetër, kryetar. Në inventarin e bashkisë të Maliqit kanë kaluar një pjesë të këtyre rezervuarve, një pjesë të mirë të tyre i ka Bordi, një pjesë e katër ministri e bujqësisë direkt, por këto që janë në varësi të bashkisë. Rezervuarët kanë ca specifika për mirëmbajtje, që me pak gjë, me pak gjë me fjalë, ato në situata të tilla me fjalë, shpëton situata që janë katastrofike. Personalisht, ne na ka ndodhur një situatë tani në një vend ku punonim në Përmet. Unë kam qenë para tre katër ditëve atje. Kanë qenë këto ditë. Vetëm sepse nuk ishte hapur Saraqineska në fund fare, që duhet që të jetë e hapur që në shtator deri në muajin mars. Duhet të jetë e hapur, mos jemi maniak, hajt të mbledhim ujë, ta kemi për vaditje. Edhe këtë përgjegjësi dhe këtë detyrim për mua e ka bashkia, e ka bordi i kullimit. Në rast se një se një Saraqineskë dhe unë e them. E them parimisht, është me ligj në muajin shtator hapen Saraqineskat, po them që mos ndodhin katastrofa, sepse kanë ndodhur në vende të tjera kjo situatë. Prandaj e them. Në këtë situatë ka shumë problematika, ndoshta, për të diskutuar. Po thashë njëherë, kjo kërkon ndoshta një kohë tjetër. Jo, sot jemi kusht emergjente. Unë edhe diçka tjetër kam. Për administratën, për drejtorinë e bujqësisë, po sidomos për bordin e kullimit. Me shtatë mijë e pesëqind e njëshin janë ndarë tokat. Ne iu thashim atyre parcelave të vogla në atë kohë Skolina, kurse parcelave pak më të mëdha janë parcelat. Skolinat me njëra-tjetrën ndahen me ato kanale dhe treta të katra. Nuk them që është detyrimi i kanalit të katërt, nuk është detyrimi i bashkisë mbi të pastruar, por është detyrimi i atyre që kanë atë tokë. E kanë atë tokë, bashkia duhet t'i detyrojë, ti e ke tokën përdorim. E përdora tokën, po toka nuk është thjeshtë, nuk është tamam, tamam private. Por toka juaj të bësh ti si të duash me atë tokë. Dhe unë them që mbyllja e atyre kanaleve të sot ik, ik, shikoj atje në ura, ç'a sjellin ato, me fjalë, ç'a nuk kanë sjellë. Po në kohën, këto kanale, me fjalë qëndronin gjithmonë funksionale dhe të hapura, ishte situatë tjetër atëherë. Por unë mendoj, ai privat që ka të që ka tre parcelat, që ka tre kanale për ta shuar, duhet ta mirëmbajë. Dhe në rast se nuk e merr mend, prandaj është bordi i kullimit. Prandaj është drejtori i bujqësisë. Prandaj janë këta specialistë, vend ta detyrojmë.

Ornildi Demollari: Luli, faleminderit.Egla, të lutem o Almir, Almir, ti ke ca shifra që s'përputhen me asnjeriun. Egla, të lutem, e ka fjalën Egla.Egla.Po të lutem, Almir.Egla, ke fjalën.

Eglantina Balli: Po, përshëndetje të nderuar këshilltar, i nderuar kryetar. Ne si popull, më tepër ime me parimin që fjalët i merr era. Unë doja të merrja fjalën që në fillim, po zoti Kupe u tregua

më i shkathët. Ne si grup dhe në emër të grupit të opozitës kërkojmë një informacion pak më të detajuar, si të themi. Me të gjithë hapat që janë ndërmarrë, kryetari përmendi pak a shumë të gjitha problematikat që u janë shkaktuar, përveç të një raporti mbi dëmet të dhëna specifike mbi dëmtimet e shkaktuara në rrugë, ara të mbjella dhe infrastruktura të tjera, përfshirë foto dhe masat marra për riparim. E dyta, plani i veprimit, informacion mbi masat që janë ndërmarrë ose planifikuar për të adresuar situatën dhe për të parandaluar dëmtimet të tjera në të ardhmen. Ndihmë dhe burime të dhëna mbi ndihmën financiare apo burime të tjera që mund të jenë në dispozicion për ndihmën e fermerëve dhe banorëve të prekur. Informacion mbi projektet e ardhshme. Një pasqyrë për projektet që lidhen me sistemin e menaxhimit të ujit dhe përmirësimin e infrastrukturës për të shmangur ngjarje të ngjashme dhe komunikimi me popullatën, si po komunikon bashkia me banorët për situatën aktuale dhe hapat që duhen ndjekur. Doja të shtoja diçka që nuk është pothuajse pak më e udhës sikur çdo administrator i njësive administrative të të pasqyronte dëmtimet e zonës të vet dhe të na i sillnin këtu dhe ti.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Atëherë, kryetarë të nderuar këshilltarë, që më datën njëzet e njëmbëdhjeti, ne kemi ngritur grupin e punës për çdo njësi administrative me përfaqësues të emergjencave civile të administratorëve të kryetarëve të fshatrave, të gjithë përfaqësuesve të cilët kanë qenë në terren, dhe ata kanë bërë këtë evidentim që unë ia lexova pak më parë. Në datën njëzet e dy, njëmbëdhjetin kemi kërkuar bazë ushqimore për blegtorinë, pako ushqimore, veshje apo batanije apo çadra, në varësi të situatës që mund të ishte. Agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, për të cilat ka filluar transhi i parë me pako ushqimore, të cilat, apo dhe me fondacione të ndryshme për përballimin e situatës në zonat të cilat prezenca e ujit ka dëmtuar bazën ushqimore apo ka krijuar probleme në familje, atë çfarë u thashë pak për rreth njëqind e njëzet e tre familje. Kjo punë është realizuar dhe ka ecur më tej. Është bërë evidentimi dhe ne u vëmë në dispozicion të gjithë informacionit që ka dalë. Për të cilën e kemi bërë prezent edhe në takimin që kemi bërë, në takimin që u realizua në bashkinë tonë, me prezencë të Ministrit të Mbrojtjes dhe të gjithë shtabit të emergjencave civile të qarkut të Korçës është bërë në bashki, ku janë bërë prezent të gjitha problematikat, të cilat kemi filluar ndërhyrje, siç thashë, në të dy lumenjtë. Dhe në mbylljen e të gjitha hyrje daljeve nëpër fshatra, pasi në momentin e parë duhet t'i mbyllim, që uji mos hynte. Pasi kemi fshatra të tillë, të cilët uji, nga sasia e madhe nga kanalet hyjnë në fshat dhe tani që flasim nga fshati, duhet t'i hapim që të mos që të lirohen edhe të ikin drejtim të kolektorëve kryesorë. Të gjithë eskavatorët kanë qenë në punë pa ndërprerje, por edhe sot që flasin vazhdojnë të jenë. Ne jemi të hapur për të ju dhënë çdo lloj informacioni për situatën dhe përmasat që do të marrim. Paralelisht me këtë, unë kam filluar pregatitjen e të gjitha shkresave drejtuar të gjitha institucioneve të Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë të Mbrojtjes, dy të paktën dy ministrive përkatëse, për efekt të investimeve bazë, të cilat janë për t'i paraprirë një situatë e tillë. Ka një projekt për bonifikimin e plotë të fushës Maliqit, po vlera është shumë e madhe ai për të cilën tha pak më parë Luli. Megjithatë, në qoftë se një projekt i tillë është i madh do kohë dhe do fonde nga Banka Botërore për ta realizuar, kjo s'do të thotë që mos ketë projekte më të vogla, siç janë. mbathja apo rehabilitimi i lumit Devoll në zonat ranore ku janë më të vështira, me rrjetë gabion edhe me gurë. Për të bërë të mundur që goditjet e fuqishme të këtij lloji të mos ndodhin më, edhe

pse ne nuk kemi patur përmbytje, prej njëzet vitesh ndodh që kjo vjen, mund të vijë edhe një herë njëqind vjet, po ne duhet të pregatitemi për këtë ditë, dhe kjo është shumë shumë e rëndësishme.

Petrit Kupe: Kisha unë diçka, duke marrë shkas jo vetëm nga fjalë e kryetarit. Por edhe ne të kemi qenë prezent, pavarësisht se nuk jemi nga ata që do të jemi atje ku. Dhe më shkas edhe nga fjalën e dy ministrave. Dhe Ministrin e Mbrojtjes dhe Ministrin e Bujëqsisë, pashë nga Ministri i Mbrojtjes që mbulon emergjencat civile një gatishmëri për të përballuar ato emergjenca që kanë të bëjnë me ushqimin e njerëzve me ndërtesat apo me ushqimin e blegtorisë. Nuk pashë nga ministri i bujqësisë ndonjë angazhim ose ndonjë premtim për dëmet e shlyrjen e dëmeve të shkaktuara në bujqësi. Janë me qindra hektarë misër të pakorur. Nuk e di sa janë me patate të pashkulura. Edhe goxha hekëtarë të mbjella me grurë, të cilat një pjesë e tyre me mua mos janë ndërtuar, por një pjesë që porsa mbjella, ato janë ndërtuar mbasi fara është prishur. Nuk e pashë këtë premtim. Edhe arsyeja është sepse akoma dëmet nuk janë konstatuar realisht, sepse uji është akoma në sipërfaqe. Por megjithatë nuk pashë kështu premtim tjetër që të thoshe, siç tha ai ministri i Mbrojtjes. Ky problem kaq i madh këto rishje prej treqind e gjashtëdhjetë milimetra. në njëzet e katër orë ose dyzet e tetë orë janë të pandodhura kur unë mos e mbaj mend me lulin nga të jeni moshatar. Në fushën e Maliqit mbytet, kam eksperiencë me njëqind litra ujë në njëzet e katër orë. Mbytet, fillon të përmbytet, jo me treqind e gjashtëdhjetë. Moti i çrregullt. Me një verë shumë të nxehtë, pesë muaj të nxehtë, patjetër do të sjellë çrregullime në klimë. Dhe ja ku u pasqyrua e thau dhe e përmbyti. Kjo kërkon edhe nga ne si këshilltar në mbështetje të kryetarit. kërkon një zgjidhje përfundimtare, një zgjidhje përfundimtare, e cila ka mundësi. Ka njëzet vjet që është folur për këtë zgjidhje përfundimtare. Për urën apo për të tjera gjëra dhe akoma nuk është për gjë, kështu që ne të mbështetim kryetarin të kërkohet me ngulm një zgjidhje përfundimtare ose një zgjidhje deri drejt përfundimtares. Sepse kjo situatë do krijohet, por ajo që është më e rëndësishme duket sikur përgjegjësia bie mbi bashkinë. Komuniteti, unë komunitet, këtë e njoh më afër, këtë ka më afër. Këtu e njoh, që më përmbyt, këtu e njoh, që nuk më shihet prodhimi. Pra, duhet dalë gjërat dhe ne do të mbështetim, pushtetin në lokal për të dhënë një zgjidhje përfundimtare. Këta kisha faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të ndryj dy momente. Momenti i parë ka të bëjë me fjalën e Ministrit të Bujqësisë, i cili të paktën është pyetur nga gazetarët për efekt të këtij momenti. Dhe ai ka deklaruar që filloni të bëhen vlerësimet e demëve, pasi sot s'mund të flasim dot. Unë mendoj që pjesa më e madhe e grurit do të shpëtojë. Për efekt të largimit të ujit, edhe ajo e ka më të lehtë. Problem ngelen patate të pashkulura, të cilat as fiksohen. Por besoj edhe Misri në pjesën më të madhe do të shpëtojë, pasi ka filluar vetëm këto ditë që flasim edhe dje e është korrur. Mund të ketë zona të veçanta të cilat, por edhe kjo duhet evidentuar, dhe ne patjetër do të çojmë. Unë kam folur dje përsëri me Ministrin e Pushtetit Vendor dhe ai më ka kërkuar të bëhet urgjentisht një rivlerësim, pasi akti normativ që mund të nxjerrë qeveria në fund të vitit mund të jetë pjesë edhe e subvencioneve. Më fal apo të mbulimit të këtyre demëve që ndodhin në fushën e bujqësisë, përsa i përket investimeve kapitalet dhe investimeve shumë të mëdha të fushës së Maliqit. Patjetër që ato kanë vlera për Kolosale dhe ndoshta mbledh tjetër edhe Këshilli i Bashkisë me një kërkesë, atë që unë po bëj vetë si institucion. Një e kam nisur dije, një po e nis

sot në drejtim të dy ministrive për efekt projekteve që kanë të bëjnë me rehabilitimin, me pastrimin e plotë dhe rehabilitimin e të gjithë pjesëve me risk në lumin Devoll. Apo edhe me atë që thotë pak më parë që tha Luli për një Hidrovor të madh në fushën e Maliqit, i cili eliminon heqjen e ujit nga pika më e vogël aty ku thuajse që mund të mbeteshe edhe kënetë. Do ishin dhe një një shkresë të themi dhe në emër të Këshillit të Bashkisë do ishte një forcë apo një zë shumë për në efekt të institucioneve përkatëse të qeverisë.

Faslli Zholi: Të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës, inderuar kryetar i bashkisë, bëmë shumë mirë që e ngriti Petrit edhe ne si opozitë. Pikën e parë, edhe pse jo, do të ishte e udhës ta kishim futur në rendin e ditës këtë situatë, sepse kjo mbledhje i përket kësaj situate që jemi aktualisht. Dhe këtu vlen që edhe të falenderoj punën e gjithë aspektit të bashkisë. Edhe kryetari ka qenë dhe unë e kam ndjekur këtë histori. Kam shkuar edhe në ura, kam shkuar edhe e gjithë. Dhe i kam parë forcat zjarrëfikëse, forcat e policisë, bashkia. Kanë bërë një punë për të thënë prej të vërtetës, po ja që prurjet kanë qenë shumë të mëdha dhe faktori është njeriu. Këtë e dimë të gjithë dhe duhet, do të ishte udhës për mua, edhe si nënkryetar i këshillit, që ta kishim vënë renditës këtë pikë. Sepse ne s'e bënim, por ç'farë ka ndodh? Një diçka neve si kryesie e këshillit të bashkisë. Si opozitë konkretisht flas, kemi kërkuar që të futen disa gjëra. Të cilat ne i kërkojmë herë pas here, edhe këtë e deshëm ta futnim edhe ta kërkonim. Nuk e bëmë, sepse e dinim që nuk do të na merresha parasysh, por gjithsesi u realizua që u hap kjo dhe u bë mirë, sepse thashë edhe një herë, alfa e kësaj pune është kjo. Tashti, për të shkuar më tutje, dua të them nja dy gjerë. Deri këtu është bërë një punë kolosale. Unë sot për veten time duhesha që administratorët të ishin këtu, të mos ia lënë vetëm Gëzim Topçiut situatën. Që edhe kryepleqtë të kishin dokumentuar se kjo është një pronë, qoftë toka, qoftë malet, qoftë pyjet, qoftë ujërat e kësaj bashkie që ne mbulojmë. Dhe këta ta kishin evidentuar me shkrim. Dhe t'ia japin dikasterit përkatës, që tek administratorët, ku janë dëmtuar, cila shtëpi është dëmtuar, cili biznes është një zonjë këtu, që është atje në fund, është në Libonik. Ka një biznes që është për ta falenderuar që e ka hapur atë biznes mbas rregullave. I është përmbytur dhe kërkoi ndihmën tek kryeplaku, tek administratorja, nuk e mori fare fjalën, më thotë mbrëmë, i thashë me hajde ta diskutojmë. Si kjo ka dhe të tjerë, kështu që neve jemi të zgjedhur, kryeplejtë janë të zgjedhur, administratorët janë të emëruar. Ti të qëndrojnë më afër dhe të mos ia lënë Gëzim të Topçiut, edhe për një llambë apo për një ndriçim që na marrin edhe unë i kam bërë edhe problemet. E falenderoj kryetarin se për çdo gjë që e ka marrë, ka qëndruar korrekt dhe me është përgjigjur. Por këtë e ka më tepër, duhet ta bëjnë ata që janë poshtë Gëzimit. Të punojnë dhe këta është përgjegjësia juaj, zoti kryetar, t'i vesh në punë, qoftë administratorët, qoftë edhe kryepleqtë. Neve si këshillë t'i ngacmojmë këtë histori, sepse, arrinën kryeplejtë për një llambë, dikush në Çaushli mbrëmë ka marrë administratoren e asaj. Një llambë, atij ishte përmbytur shtëpia, edhe nuk shikonin fare as drita, asgjë. Për një llambushkë kaq fukare nuk jemi ne. Të vëmë një dritë ndriçimi atje që të shkojë njerëzit si njerëz. Dhe desha të thosha në këtë histori, zoti kryetar, dhe këshillit, që këto do menaxhohen tashi. Ju i keni filluar punët. Na i dhatë atë përmbledhjen. Jam plotësisht dakord. Po ka dhe më e rëndësishme është tashti që ne sa do të mundemi që t'u vijmë në ndihmë ato që thamë, që te patatja te misri ça mund të shpëtojmë. Dhe të bëhet një evidentim, thashë, që na baza edhe deri tek juve, që kjo të bëhet mos na ndodhi siç bëmë atëherë. Që për punën e qershive

e kërkuam atë mbledhje, e bëmë dhe erdhi si përfundim. Do bëjmë vlerësim, do bëjmë vlerësim me qëllim që t'u afrohemi qytetarëve, sado pak të mos i lëmë vetëm në ato shpenzime që kanë, sa të jetë e mundur, po që mos i lëmë vetëm që neve të jemi afër për t'i financuar dhe për t'i ndihmuar aq sa mundet fondi i bashkisë apo fondi që do të jepen nga organizmat e tjera. Duke i uruar suksese dhe punë të mbarë Faleminderit.

Ornildi Demollari: Lola Shkurt, të lutem.

Floreta Zaçe:Përshëndetje!Pavarësisht kushteve atmosferike që po përjetojmë, unë desha të ndaja një problem aty ku bashkia ka fajet e veta edhe komuniteti, rasti konkret, ne për fshatra, ne jetojmë në fshat dhe jemi bujq vetëm për këtë gjë. Komuniteti kërkon ato gjëra që i ka bërë fajet vetë. Rastet janë të shumta në kanalet, edhe vaditës edhe kullus është për të erdhur keq. Bashkia gjatë gjithë kohës ka hedhur, i ka pastruar, i ka dalë. Nuk ka vajtur dy javë. Unë e kam shumë afër këto kanale dhe përsëri mbushen. Rrënjët e misrave tashi që po korren, rrënjët i marrin dhe hedhin në kanal. Kanalët janë tërë të zëna. Në kohën kur duhet të bëhen vaditjet, po në kohën kur bëhen vaditjet, janë vënë tubat e kanalit që të kalojnë, domethënë si punë urre të kalojnë, dhe ato i ka mbushur me dhe. Domethënë, komuniteti nuk është kaq i ndërgjegjshëm që të kërkojë direkt të bashkisë, të kthehet në vetvetja për gabimet që ka. Tjetër, unë e kam mbajtur edhe herë të tjera për problemin e plehrave. Edhe brenda fshatit, komuniteti nuk është përsëri i ndërgjegjshëm. Ne e mbështesim, jo të gjithë. Më vjen keq, unë të flas për këtë në përgjegjësi. Ka në përgjegjësi, janë fajtorë. Unë e kam ngritur edhe në lagje ku jam atje. I kam thënë këto plehra. Ju lutem, edhe pse kërkonin nga bashkia? Bashkia po vijnë e ngre, ti zotëri, nuk hidhet kjo këtu. Përsëri ndodh e kundërta, kështu që, të ndahen përgjegjësitë, pavarësisht për kushteve atmosferike, thashë që në fillim që nuk janë në dorën tonë. Bashkia deri diku, jo se jam unë kjo dhe duhet të flas për bashkinë, po janë bërë punë. Dhe është gjynah të diskutohet përgjegjësitë të mbahen dhe nga vetë komuniteti. Për gabimet të mos të mos jenë këto gjë, unë besoj që të gjitha parafolësit që folën në këtë drejtë, në këtë pikë e kishin. Prandaj, kështu, çdo gjë të bëhet në kohën, edhe në kohën e beharit ndodhin këto gjëra, edhe në kohën e beahrit për t'ua vaditur e për të bërë, ka shumë probleme, megjithatë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, duhet të jemi të ndërgjegjshëm pak edhe vetë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Që ju të vazhdoni me pikat e tjera, unë po e citoj edhe një herë. Situata është komplekse dhe patjetër edhe ato problematika që ngriti Lola pak më parë. Edhe aty ka përgjegjësi bashkia në kuptimin deri diku për të kontrolluar, për të ndjekur, për ta, për t'i gjobitur të themi edhe aty qytetarin që është i pandërgjegjshëm, domethënë. Është komplekse, unë nuk dua të heqim asnjë gjë nga vetja jonë, përjashtuar atë pastaj që kur është një emergjencë e tillë që po ranë 380 litra, po shyqyr që ishte edhe toka e thatë. Që një pjesë të lagështisë e merrte për efekt të thatësirës që kishte prej muajsh pa rënë, se ajo lagështi nuk i çar i bën pastaj e kupton të vjen treqind e tetëdhjetë litra për dy-tre ditë mililitra. Megjithatë, ne duhet patjetër të marrim masa urgjente për atë çfarë mund të rregullojmë hapjen e grykave të kanalëve, që ajo të lirojë sa më parë. Dhe të shpëtojmë sa më shumë toka bujqësore të pambjella, të mbjella

apo prodhime bujqësore, të cilat nuk janë tërhequr nga fusha. Dhe patjetër, ne do të vazhdojmë me evidentimin e çdo situate të dëmtuar në territor, për t'i çuar propozimin qeverisë Ministrisë së Bujqësisë për efekt kompensimi në këtë pike, jam i hapur që edhe këshilltarët, kryetarët e fshatrave, të bëhen pjesa jonë për situata që kanë në çdo fshat, në çdo zonë. Ne jemi të hapur për këtë pjesë, jemi të gatshëm t'ju japim çdo informacion që kemi evidentuar deri në këtë moment dhe për të përballuar bashkërisht këtë situatë, e cila në një farë mënyre nuk është e zakontë. E falenderoj këshillin edhe për vërejtjet dhe anëtarët e këshillit për vërejtjet apo për sugjerimet që japin, pasi janë shumë të domosdoshme edhe për ne në këtë situatë. Në qoftë se s'ka një pyetje tjetër, do desha me kuptimin tuaj për të më dhënë leje që unë të vazhdoj me angazhimet time në territor.

Petrit Kupe:Në qoftë se dy minuta kohë ne si komision e pamë atë për vendimin e agjensisë. Edhe jemi dakord që kjo agjensi të mos funksionojë. Aty ka shumë shkaqe, por fakti që nuk kanë funksionuar, fakti që unë e kam përmendur edhe në një moment te kryetari, e kuptoj deri në fund të shtatorit ishin realizuar njëzet për qind e shpenzimeve operative. Për shumë arsye, nuk ka funksionuar dhe jemi dakord që të riorganizohet. Ndoshta është momenti në strukturën e re të vitit të ardhshëm, të renditen ato që përbënin pjesë të kësaj agjensie, të renditen sipas natyrës, sipas karakterit që përputhen. Nuk ka llogjikë që kultura të ishte në këtë agjensi që s'ka. Unë kam parë një strukturë orientuese diku në Vorë edhe ajo nuk është, edhe të tjera e tjera duhet të renditen sipas strukturës, sepse të vjen të sigurohet me fonde dhe të vihen në punë sipas atyre, prandaj jemi dakord që ta miratojmë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në qoftë se si ju falenderoj, në qoftë se si një gjë tjetër, unë jam i gatshëm t'i kthej përgjigje gjithë problematikave që ndodhin në territor, pasi duke jo çdo gjë e kapim ne në momentin më të parë në tetëdhjetë fshatra. Nuk e kapim dot, po kur informacioni vjen edhe rekordohet me të gjithë aktorët, kjo ndoshta nuk bëhet menjëherë, por futet në axhendë për t'u realizuar sa më parë.

Ornildi Demollari: Faleminderit për pasqyrën, faleminderit për gatishmërinë, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po patjetër Lindita, Lindita të vijë tani, të kenë hyrë të tëra ujërat nga puna. Lindita të takojë tani sektorin e emergjencave, komisionin që po merret me evidentimin, të vijnë ta bëjnë situatën në vend, shumë mirë bëre që e sjell prezent edhe shqetësimin në këshillë, po ata do hedhin në letër çdo gjë që ka.Të falenderoj unë ty, shumë faleminderit të gjithëve.

Ornildi Demollari: Të lutem të autorizoni dikë të shoqërojë mbledhjen e këshillit. Atëherë faleminderit, ju lutem të miratojmë rendin e ditës, sepse dskutimi nisi pa dhe natyrshëm, sepse situata me përmbytjet ishte shumë e rëndësishme. Por këtu ngelëm, duhet të miratojmë rendin e ditës dhe të vijojmë më pas pastaj me pikat me radhë. Kush është dakord me rendin e ditës?

Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet rendi i ditës. Faleminderit. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar. Janë gjithsej nëntë vendime me karakter normative dhe gjashtë me karakter kolektiv, të cilat janë kthyer në vendime tashmë, ato të cilat kanë shkuar në institucionin e prefekturës, janë kthyer në vendime, dhe ato që nuk shkojnë, janë kthyer në vendime gjithashtu. Janë gjithsej pesëmbëdhjetë vendime. Më lejoni t'ju kujtoj konfliktin e interesit të nderuar këshilltar në qoftë se ndonjëri nga. Nga ju, nga ne ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës. Është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutime, as në votim. Tani ju ftoj të miratojnë procesverbalin e mbledhjes së kaluar, mbledhjes së datës tridhjetë i nënti dy mijë e njëzet e pesë. Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. miratohet procesverbali. Faleminderit tani kalojmë tek pika katër e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin shtator dy mijë e njëzet e pesë. Tek ndihma ekonomike, po.

Faslli Zholi: Pika katër është si zakonisht miratimi i ndihmave ekonomike. Neve dje unë erdha këtu. Komisionet, siç e kam thënë, dhe që parë i bëmë edhe një bisedë të lirë. Nuk mblidhen përveç komisionit të financat që mblidhet, e kanë shumë mirë dhe dua ta falenderoj të gjithë anëtarët. Dhe kjo do t'i dhënë një rrugë zgjidhje që o do ta lëmë ditën e ta bëjmë këtu së bashku, ta lëmë ditën e mbledhjes nga ora tetë a nëntë, si të doni. Që të mos ketë më avarira te komisionet, të bëhen ashtu siç janë bërë deri më sot. Që të mos e ripërsërisim sa herë ta bëjmë këtu, ta bashkërisht. Kur ta lëmë orarin dhe gjithë anëtarët e komisionit, kush nuk vihen pastaj, të merren masa ndëshkimore. Ky është mendimi im. Pika katër për mua si anëtar i komisionit të kalojë dhe kam një diçka në emër të opozitës e thashë dhe që pari, ne jemi të pakënaqur në shumë arsye, sepse kërkojmë në kryesi. Bile, unë do dal nga grupi i kryesisë, deri sa juve që të merrni masat si mazhorancë, kërkesat tona si opozitë, kur neve duam të ngrejmë diçka. Po bëj dy vjet që jam në këtë këshillë, unë dhe kolegët e mi nuk është marrë parasysh asnjë kërkesë që neve duam të futemi në rendin e ditës të këtij këshilli bashkiak. Për të cilën e thashë dhe që pari, pika ime kryesore dhe opozitë dhe kolegëve të mi ishte sot ajo që ne diskutuam e bëmë shumë mirë, po duhet ta kishim futur në rend dite. Ne jemi anëtarë kryesie, e di secili pozicion që ka, dhe tashti, pse të merren vendimet? Vendosi kryesia kështu, kur ne nuk na merret asnjë, neve atëherë të dy të opozitës që jemi, edhe çupa dhe unë. Mbajni vetë dhe është më mirë kështu se sa neve të përfshihemi në këtë histori, o do ta zgjidhni këtë histori që edhe neve si këshilltarë, se unë këtu nuk përfaqësoj demokrate, socialiste, po përfaqësoj të gjithë qytetarët pa parti e me parti e pa të tjerë. Kur them unë edhe të gjithë të tjerët, kështu që ne kërkojmë këtë dhe jemi të pakënaqur nesër të mos thuhet pastaj që opozita kështu, opozita kështu. Neve jemi vërtetë një grup, ju i kini numrat. Çdo gjë mund ta bëni, por neve që në fillim, që të bëjmë konsensus se ne këtu nuk bëjmë politikë, këtu zgjidhim problemet dhe menaxhojmë situatatat bashkë me ekzekutimin, bashkëpunim për të realizuar ato që kërkojnë qytetarët, aq më tepër që është edhe situata sot. Faleminderit kështu që unë e miratoj këtë të ndjerë ekonomie, po të zgjidhet kjo e

komisionit. Që komisionet të funksionojnë në Bashkimin e Maliq dhe për këtë të kryesisë e thashë, unë do dalë gjer juve të nxirreni mendjen që neve të na hapet krahu në të.

Ornildi Demollari: Ju s'vini për ne, e keni detyrim ligjor. Jo, jo, e kemi detyrim ligjor.

Faslli Zholi: Po dhe ju keni bashkëpunim, bashkëpunim për ne. Që ne kërkojmë, jo. As për njëherë, as ti s'vjen për mua, as kushdo, por ne kemi thënë që të bashkëpunojmë dhe të jemi konsensual në pikat që kanë dhe prekin të gjithë qytetarët. Kjo ka shumë rëndësi, kësaj duhet e shoh. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Tek ndihmat ekonomike, jo një moment, të lutem, Ermanda ka erdhur një kërkesë në drejtim të institucionit tuaj, shërbim social. Ja që drejtuan këshillit, edhe më duhet ta t'ia paraqes këshillit. Unë i nënshkruaj gjë që Gozhdari thotë me banim në fshatin Lozhan. Ju paraqes kërkesën time për ndihmë ekonomike nga Bashkia Maliq, pasi kam aplikuar te zyra sociale në njësinë Gorë për ndihmë ekonomike. Por nuk kam përfituar, pasi isha me pikë të pamjaftueshme. Dhe dua të futem tek ndihma gjashtë për qind. Pasi të ardhurat e mia janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet familjare, pasi jam transferuar edhe me qera në qytetin e Korçës. Për të ardhmen e fëmijëve kam katër fëmijë, njëra vajzë në shkollë të lartë në Korçë dhe një djalë e ka me probleme shëndetësore dhe më duhet t'i bëj terapi. Thotë se ka probleme me të folurën dhe dëgjimin. Shpresoj ta merrni parasysh. Ish drejtuar këshillit, po është për ju dhe desha ta ndaja me këshillin. Hapeni këto punë.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Po e verifikojmë si rast dhe mund t'ju kthejmë përgjigje në mbledhjen tjetër.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Atëherë, tek pika katër, kemi gjë tjetër?Pyetje? e kalojmë votim?Atëherë kush është dakord me pikën katër? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet pika katër, faleminderit. Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës, projekt vendim për dhënien për dhënien ndihmë financiare për familjen e Zotit me inicialet PB, banues në fshatin Sovjani, si administrative Pirg. Banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit. Kalojm në votim?
Atëherë kush është dakord?18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet, faleminderit. Të kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, projektvendim për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qerasë. Pika gjashtë kanë nevojë për ndonjë. Shpjegim këtu, normalisht duhet të shiko, normalisht duhet të funksionojnë komisionet, sepse. Një pjesë e mirë e këtyre materialeve dhe diskutimeve shteren në komision dhe këtu bëhet e lehtë puna pastaj.

Idlir Limllari:Është bërë mbledhja në datën dymbëdhjetë të njëmbëdhjetë dhe janë bërë pikëzime sipas ligjit njëzet e dy të dy mijë e tetëmbëdhjetës për strehimin. Nuk ka ndonjë ndryshim nga vitet e tjera, kështu që s'kishte ndonjë problem. Kështu që mendoj që të kaloj.

Ornildi Demollari: Faleminderit, e kalojmë votim. Atëherë, kush është dakord?18 vota pro. Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet faleminderit. Kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, projekt vendim për mbylljen e agjensisë së shërbimeve mbështetëse Maliq dhe kalimin pranë strukturës së bashkisë Maliq.

Prnavera Begolli: Gjithë sqarimet u bënë në Komisonin dhe ne Kryetarin në mbledhje.A detyrimisht ne e lamë si komision i financës? Kështu, Egla. Që aktualisht të gjithë sektorët të vijnë ku janë përkuljet për kurimet, juristët e juristët, bordi i kullimit të ketë më vete. Si kusht, ata punonjës janë të shërbimeve të vendit nëpër zyrat përkatëse që u përshtaten profesioneve të tyre.

Ornildi Demollari:E kalojmë votim?
Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka Miratohet pika shtatë. Faleminderit të kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës. Projektvendim për një ndryshim në vendimin e këshillit. Bashkiak Maliq, numër shtatëdhjetë e pesë, datë tridhjetë e gjashtë të dy mijë e njëzet e pesë, për ngritjen e bordit artistik të Bashkisë Maliq. Po, në qoftë se kush e ka parë materialin, ai i kishin bërë shpjegimet atje ata se si bëjnë disa ndryshime.
Prnavera Begolli: Tek ai thamë që do ishte pa vlerë pagesë, se tani e kam futur me vlerë, por e keni parasysh që në mbledhje kam kërkuar që në ai komisioni i kulturës, përveç administratës apo të tjerëve, të jenë të përfshirë edhe këshilltarë, që janë pjesë që e njohin artin dhe kulturën, por edhe qytetarë, që vërtetë janë marrë me ardhjen në kulturë në qytetin e Maliqit. Të paktën të ketë parasysh kjo të.
Ornildi Demollari:E kalojmë votim atëherë?
Kush është dakord kundër? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet.Faleminderit.Kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës. Projektvendim për miratimin e dokumentit të politikave, planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Maliq. Për periudhën janar-dhjetor dy mijë e njëzet e gjashtë, pra është. Plani i punës së të këshillit për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. E pat kush, kush është dakord? Ka ndonjë koment këtu?

Pranvera Begolli: Komenti është ai që tha dhe Fazlliu. Vërtetë miratojmë një plan për këshillin dhe shyqyr që edhe fondet ishin rritur, më duket. Por është ajo e komisioneve. Derisa ne jemi anëtarë të Këshillit Bashkiak, derisa futemi në një listë, bëjmë namin për të qenë në atë listë, për të hyrë, për të qenë përfaqësues këtu. Përfaqësojnë komunitetin, atëherë për të ardhur në një

komision, në qoftë se nuk e kanë mundësinë për të ardhur një ditë përpara, le të vijnë si ne. Komisioni i financës, funksioni i ligjeve, gjysmë ore para mbledhjes. T'i kenë parë materialet që më përpara dhe pastaj t'i diskutojnë, por kur ti nuk je efektiv në komisione, nuk ke çfarë jep dhe çfarë bën.

Ornildi Demollari: Kush është dakord kundër? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet edhe pika nëntë. Faleminderit, tani jemi tek pika e fundit, pika diskutime të tjera, por a kryetar mund ta marrë fjalën për këtë diskutime të tjera? Po.

Pranvera Begolli: Aktualisht, këshilli i bashkisë është këshillë vendimarrës, pra ne marrim vendime dhe administratë është e detyruar t'i zbatojë. Kemi marrë vendime për dhënie tituj. Dhe kur ne i marrim këto vendosjen e titujve, aktualisht këshilltarët nuk informohen për të qenë prezent në momentin. Kur këta njerëz marrin atë çka ka marrë vendim këshilli. Komisioni i kulturës. Sekretari nuk më duhet, sekretari i këshillit të bashkisë, të koordinojë veprimet me komisionin e kulturës a të titujve dhe këshilltarët të informohen. Pastaj kanë dëshirë të vijnë apo të mos vijnë. Është tjetër gjë, por të jem prezent, patjetër në informim e para, e dyta, kemi kërkuar rresht pas rreshti në çdo mbledhje. Merrni si të doni. Nuk e kuptoj përse profesor Gjergji Merlikës nuk po jepet titulli. S'më bëhet ceremonia. Arsyeja nuk e kuptoj një profesor që me dekada ka nxjerrë breza nga të gjitha llojet e profesioneve. Një profesor që ka ngrënë edhe luftën e klasave atje në Senisht, ku bëri tërë elektrifikimin e fshatit, nuk e marr vesh arsyen pse. Ai komisioni i kulturës, kryetari i komisionit të kulturës, se si të mund të vinte këtu të ishe sot prezent, të na jepte llogari. Arsyeja pse? Jam mirë, nuk kam pse për vlerat që japim Gorës për ato ç'ka bëjmë, por ama. Mund të them që u bëj të viti për t'i dhënë një medalje, një titull. Profesor Gjergji Merlikës, nuk më duket normale.

Ornildi Demollari: Po mirë, tani ai s'është këtu, s'është as kryetari këtu tani. Dakord.

Floreta Zaçe: Edhe unë si kryetar i këtij komisioni mendoj dhe kam edhe në momente të lira me këshilltarët. Kam menduar që vërtetë, kjo është e vërtetë dhe nuk është problemi vetëm për dy veta. Të flasim gjithmonë për Gorra, Gorra. Po ka dhe fusha, ka dhe maliqi, ka dhe shumë njerëz që kemi. Kemi çuar te juristi disa emra, por mendoj që me rastin e 28-29 nëntorit, bashkia mundësisht të ketë disa vlerësime për njerëzit që kanë dhënë kontribute dhe vazhdojnë t'i japin. Se sa do të realizohet kjo, nuk e di. Ne në komision jemi mbledhur edhe me opozitën. Edhe ata kanë ato problemet e tyre, ankesat, po sigurisht dhe neve. Faleminderit.

Faslli Zholi: Tashti në këtë histori që ta mbyllim, falenderoj edhe verën edhe zonjën atje. Neve e kemi kërkuar hera herës, unë komunikova edhe me kryetarin e këtij komisioni që jemi së bashku atje. Dhe nuk u mblodhëm, nuk mblidhemi. Edhe një diçka që më shqetëson mua, bëhen mirë, bëhen në Gorë. Po si më në mos thërret një këshilltari i Gorës, ose të bëhet një aktivitet në zonën e Moglicës, edhe të mos jem unë, a mos jem këtu. Do të ketë një bashkëpunim këshilli. Prandaj, kjo është edhe detyra jonë si kryesi, kryetar. Të të të bashkëpunohet me me këshilltarët.

bëjë po edhe sekretari i Këshillit, të informohemi. Marrim vendime këtu, siç e tha zonja atje në fjalë. Nuk zbatojmë vendimet e këshillit, do të thotë pastaj ç'arë, ç'arë do të, duhet të gjejmë pikën, pse nuk është zbatuar një vendim i këshillit. Pse nuk është zbatuar një vendim i këshillit që ne kemi marrë? S'është bërë kjo, bëhet aktivitet ceremonial, shumë mirë që bëhet për Gorën, për Devollin, të bëhet . Për këdo, po të ketë ndonjë koordinim kështu, unë për veten time, çdo aktivitet që është kryer në emër të këshillit, unë kam qenë president bashkë me ju apo jo? Në dëgjesa, po në zgjedhjet e krye pleqësisë, po nëpër fshatra, po në të po edhe juve nuk na thoni njerëz, unë kam qejf. Kam qejf që këshilli dhe të bashkëpunojë, që edhe për fatkeqësitë, ore të ngrihem një ekip në emër të këshillit. Ka rënë fatkeqësitë, të ngrihemi në këshill dhe të vijmë t'i vizitojmë, t'i vizitojmë, t'i shikojmë me sy. Këshilli të koordinojë punën me komunitetin dhe të shkojmë ku është situata më e vështirë. Është iks fshat, të vejmë atje. Prandaj jemi të zgjedhur ne, kjo që dhe një diçka tjetër kam depozituar një shkresë. Nuk e di a ka erdhur këtu. Në kërkesë të disa qytetarëve kam dhënë dijeni dhe kryetarin ta mbash ti çupëshni. Bëhet reparti i poçestës, shumë mirë që bëhet. Më bëhet qejfi që ngrihet institucionet ushtarake edhe në territorin tonë. Dhe kam marrë informacion, kam shkuar atje që ata e kanë preventivin deri në rrugë dhe i kanë lëshuar ujërat e zeza, ujërat e bardha në rrugë. Nuk është problemi i shtatë familjeve atje, po është problemi i të gjithëve, sepse do shkojë edhe rrota e makinës. Ajo është epidemi, do shkojë për në Klocë. Ia kam thënë kryetarit, tha mirë që më the, po ta shikoje çupat, e kam bërë dhe një shkresë dhe unë e kam firmosur, që e kam parë situatën dhe ta zgjidhin këtë punë, ta ndjekin, që nuk është detyra e bashkisë, por bashkia, derisa është në territorin tonë, t'i kërkojë llogari. Ai preventiv, që është bërë njëqind lekë, atë bëhet një mijë e dyqind, edhe ta pastrojnë të shkojnë ujërat për shtatëdhjetë metra në kanalin në vendin e duhur. Ky ishte si shqetësim që ma kanë dhënë, dhe unë e kam depozituar në sekretari këtë histori. Këto desha t'thoshja.

Ornildi Demollari: Tani, meqënëse ja ai moment se, meqënëse e u ndalët këtu për këtë pjesën e. propozimeve për rendin e ditës në opozita, se mund ta kishim biseduar në mbledhje të kryesisë, këtë po ju e bëtë këtu publike. Keni kërkuar vazhdimisht, vazhdimisht, ndër të tjera, zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave në Zvezdë dhe Drithas. Keni kërkuar ndër të tjera, ndër të tjera, po vazhdimisht, vazhdimisht, vazhdimisht, se më është fiksuar titujt e nderit. Tani ju lutem të ndalem pak. Këtu për punën e zgjedhjeve të kryetarëve në dy fshatra, ne kemi qënë në një proces gjyqësor. Të ngritur nga ju, i cili mund të na i rrëzonte të gjithë procesin e zgjedhjeve në të gjitha fshatrat, dhe ne do duheshe të bënim zgjedhje në të gjitha fshatrat, nëse do na e kishte rrëzuar gjykata, e cila nuk na i rrëzoi. i quajti të vlefshme. Dhe tani që mbarovi procesi gjyqësor, jemi gati të fillojmë me zgjedhjet në dy fshatra dhe në një fshat tjetër, tani që ka ndërruar jetë kryetari i fshatit. Tani jemi gati të fillojmë zgjedhjet në këto fshata. Iku kjo e dyta, është titujt e nderit. Tani ju lutem, përse na kërkoni ne, kur për titujt e nderit ka një komision? I cili mblidhet, i diskuton, i shqyrton dhe i sjell në këshillë. Tani, çfarë t'ju them unë si kryetari i këshillit apo kryesia? Në këtë rast, çfarë t'ju thotë ju për titujt e nderit? Futini në rendin e ditës, po si t'i futim, nuk i ka sjellë komisioni. Ça të futi në rendin e ditës? Ndërsa, ndërsa, ju lutem, për pjesën e aktivitetit që u bë para tre ditësh për katër shkrimtarët e Gorës, po keni shumë të drejtë. Keni shumë të drejtë, faktikisht edhe unë u njoftova shumë vonë. Megjithatë, këtë lloj problemi e

diskutoj me sekretarin pas mbledhjes, se çfarë do të diskutojmë këtu. Na njoftuan vonë dhe nuk arritëm dot t'iu thoshim. Kini shumë të drejtë, parimisht kini të drejtë, faleminderit.

Server Xhuti: Kemi një vakancë në këtë këshillën e qarkut.

Ornildi Demollari:Apo është edhe ajo e këshillit të qarkut?

Lulëzim Hoxhaj: Po në lidhje me këtë, falni, jo në lidhje me këtë që thotë Serveri. Doja të shtoja, meqë tani, meqënëse na i premtuat dhe tha që do na i lini ne si opozita, prandaj po e vononi?

Ornildi Demollari:Jo, më nuk po e vonojmë. E vërteta është që maxhoranca nuk ka sjellë akoma. Keni sjellë ju një propozim dhe maxhoranca nuk e ka sjellë, meqënëse ata nuk ashtu e keni juve. Tani ta vendos maxhoranca, sot s'është as kryetarja e grupit. Ta vendos maxhoranca dhe patjetër s'kemi asnjë lloj gjëje.

Lulëzim Hoxhaj:E bëjmë sot.

Faslli Zholi: Sqaroi Nildi se ti vërtetë e sqarove. E the që ne kemi shkuar në gjyq, shkuam në gjyq pasi na ka rënë goja lesh, që të bëhen zgjedhjet siç u bënë të gjitha ato. Pavarësisht me të mirat e të këqijat që ishte shkelur ligji që ju kishit miratuar, kur ne nuk kishim pjesa të këtij këshilli. Prit, prit, duro, duro, më duro tashi, duro dhe nuk e bëmë tashti, na dalë na ka sajuar ankimuat dhe na u paska penguar gjykata.

Ornildi Demollari:Nuk na pengove gjykata, jo, nuk na pengove gjykata, mund të na i rrëzonte gjykata të gjithë procesin.

Faslli Zholi: Ne e kërkuam, po pikërisht ne e çuam, sepse na detyruan.Na detyruat, na detyruat kur ne e vendosëm këtu në këtë këshillë. Që të bëhesh e thatë, që nuk bëhet në dritë as poshtë, sepse është e më lartë, e më poshtë erdhi e drejta që të bëheshin zgjedhjet. Nuk e bëtë, nuk e bëtë zgjedhjen në Zvezdë. Nuk e keni bërë iks vend, po të them edhe dy-tre raste të tjera. Dhe ne i kërkonim edhe me debat për ta futur rendin e ditës. Ju nuk i futnit, tashi thotë. Jo, kështu po kthejmë. Tashti, edhe neve jemi një, sepse ne jemi këshilltarë. Ti përsërit sa herë të duash. Ne ndaj e ankimuam, se na detyruat juve për ta.

Ornildi Demollari:Për çfarë ju detyruam?

Faslli Zholi: Na detyruat, sepse shkelët ligjin, shkelët rregullore. Pikë,

Ornildi Demollari:Po gjykata çfarë tha?

Lulëzim Hoxhaj: Gjykata, jo të lutem, jo ta them unë çfarë tha gjykata, o ti ta them unë, më fal një minutë. E kryetarit të parë, ai vendim nuk është ashtu siç tha aty. Nuk është e vërtetë, të lutem, se po u ka qenë. Jo, kam qenë atje prandaj.

Ornildi Demollari:U përpoqa të bëja një shpjegim, sepse ne, jo ke të drejtë, ke të drejtë. Se ne nuk kemi vijuar me këtë punë, ore dakord, realisht. Menduam që gjykata mund të na i rrëzonte të gjithë procesin në të gjitha fshatrat dhe do të duheshe që ta bënim në të gjitha fshatrat.

Lulëzim Hoxhaj: Gjykata është shprehur që kjo i takon një gjykate tjetër. Do të kalojë në gjykatë tjetër.

Ornildi Demollari:Tani unë e kam vendimin e gjykatës këtu.

Lulëzim Hoxhaj: Mirë, mire, dakord. Tani e dyta, po vazhdojmë. Jo, varet nga interpretimi që i bëhet, po që kështu është. E dyta, kryetar, e dyta, kjo nuk do të thotë se është një proces gjyqësor. Edhe të mos bëhen zgjedhjet.

Ornildi Demollari:Po mund ta rrëzonte të gjithë procesin.

Lulëzim Hoxhaj: Po nuk e rëzon, se po të bëhen këto zgjedhje, që themi neve të bëhen korrekt. rregullave nuk ka, nuk ka ndonjë problem them.

Ornildi Demollari:Por mund t'i bënim të gjithë këtë proces në të gjitha fshatrat.

Pranvera Begolli: Megjithatë, po i tërni kot, aktualisht u mor që do bëhen zgjedhjet në fshatra që kanë mbetur.

Ornildi Demollari:Kemi dy fshatra. Kemi Zvezdën që është fshat për kryetar fshati, kemi Drithasin ku prefektura na sugjeroi që të quhet kujdestar fshati. Tani kemi për të bërë edhe në fshatin Rrovë, pasi kryetari i fshatit atje ka ndërruar jetë. Shumë shpejt, pasi palët e këshillit të bien dakord, shumë shpejt do të lëmë datën e zgjedhjeve. Kaq e thjeshtë.

Ornildi Demollari: Ju faleminderit, kjo ishte mbldhja për sot, ditë të mbarë.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI